



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1015/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbarimore të kreditorit Ekonomia Online SH.P.K, me NUI:810805335 dhe NRB:70700492, me seli në Prishtinë, rruga “Mark Isaku”, nr.12 Banesa B2, kundër debitorit Radio Televizioni i Kosovës - RTK, me seli në Prishtinë, rruga “Xhemail Prishtina”, nr.12, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.164/2023 të datës 16.06.2023, të Përmbaruesit Privat Driton Govori, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datës 29.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Radio Televizioni i Kosovës – RTK, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.164/2023 të datës 16.06.2023, të Përmbaruesit Privat Driton Govori.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbarimor P.nr.164/2023 i datës 16.06.2023, i Përmbaruesit Privat Driton Govori.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ekonomia Online SH.P.K, ka lëshuar urdhër me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.251121 të datës 17.11.2021, Faturës Nr.220921 të datës 17.09.2021, dhe Faturës Nr.20521 të datës 11.05.2021, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën e mbetur prej 2,166.66 €, me kamatë ligjore ashtu siç e parasheh LMD-ja deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, në të kundërtën përmbarimi të realizohet me bllokimin e llogarive bankare të debitorit në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe bartjen e mjeteve nga llogaria bankare e debitorit në

Ilogarinë e veçantë bankare të zyrës përmbarimore “GovEX”, në Bankën Ekonomike Nr. 1401000001352747, nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare përmbarimi të realizohet përmes regjistrimi, konfiskimi dhe shitja e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në tërë masën pasurore të debitorit deri sa të kryhet tërësisht obligimi i të njëjtit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se fatura në bazë të së cilave është iniciuar procedura përmbarimore nuk janë të përshtatshme për përmbarim, pasi që të njëjtat janë kopje, si dhe nuk janë vërtetuar konform ligjit në fuqi, çka e bënë të paqëndrueshëm faturën të paraqitur si titull me të cilin do të lejohej përmbarimi, si të tilla nuk përmbajnë tipare të përmbarueshmërisë. Ka theksuar se fatura nuk është e nënshkruar nga debitori kështu që urdhri përmbarues është lëshuar vetëm në bazë të këtyre faturave dhe lejimi i përmbarimit është bërë pa u plotësuar kushti ligjor në kuptim të nenit 29 par. 3 i LPP-së. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri Përmbarimor P.nr.164/2023 i datës 16.06.2023, i lejuar nga përmbaruesi privat Driton Govori.

Kreditori në përgjigje në prapsim ka deklaruar se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe rrjedhimisht në kundërshtim të plotë me nenin 69 dhe 71 të LPP-së, pasi që nuk ekzistojnë asnjë nga shkaqet për të ushtruar prapësim. Ka shtuar se pretendimet e debitorit se faturat nuk janë në origjinal, ka për qëllim vetëm zvarritjen e procedurës përmbarimore, pasi që debitori nga 12 faturat e lëshuara për 12 muaj, 10 fatura janë paguar, ndërsa 2 fatura jo, megjithatë ka theksuar se të gjitha faturat janë të nënshkruara, si dhe në të gjitha komunikimet që ka pasur me zyrtarët e debitorit, asnjëherë nuk është thënë se ka ndonjë problem me pranueshmërinë e faturave, por vonesa në pagesë është si pasojë e mungesës së buxhetit. I ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.164/2023 i datës 16.06.2023, të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat, në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbnim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbnim me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbnim për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbnuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr.251121 të datës 17.11.2021, Faturën Nr.220921 të datës 17.09.2021, Faturën Nr.20521 të datës 11.05.2021, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në to janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbnimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbnimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbnimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1015/23, datë 29.09.2023

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.